



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.523/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hazbi Bajra, sekretar i subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si e bazuar ankesa e sekretarit të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, e cila mban shenjën ZL.Anr.523/2017, e datës 25.10.2017, kështu që subjektit politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 750.00 (dyqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbartimit**.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 25.10.2017, ka pranuar një ankesë nga Hazbi Bajra sekretar i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Istog, në të cilën pretendon se në afërsi të Qendrës së Votimit 0601c në Istog, është vendosur një billboard me foton e bartësit të listës Naim Imeraj, nga radhët e subjektit politik AAK. Me këtë rast thekson se është shkelur Rregulla Zgjedhore.

Parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 25.10.2017, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka theksuar se vendosja e billboardit në Komunën e Istogut nga ana e kandidatit të AAK-së, Naim Imeraj është bërë me rastin e fillimit të fushatës zgjedhore me datë 20.09.2017, AAK ka bërë thirrje që të respektohet heshtja zgjedhore dhe rregullat e ditës së votimit. Më tej thekson se neglizhenca e kompanisë me të cilën kemi kontratë, nuk e ka bërë heqjen e materjaleve reklamuese në afërsi të Qendrave të Votimit.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur: Kontratën me Kompaninë përgjegjëse për vendosjen dhe heqjen e reklamave, si dhe thirrjen publike të AAK-së me datë 20.10.2017 për respektimin e heshtjes dhe ditën e zgjedhjeve.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka vlerësuar se bartësi i listës, Naim Imeraj nga radhët e subjektit politik AAK, ka shkelur Rregullat Zgjedhore, duke mos hequr materialet reklamuese në afërsi të Qendrës së Votimit 0601c në Istog, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.523/2017 me datën 25.10.2017



Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*